

BASHKIA KAVAJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga “Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10,

Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com

Tel: 055245555

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 21870 m² e pasurisë nr. 458/3, lloji pasurisë “pemëtores” pasuri e cila është në përdorim të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë në vol. 2 faqe 64 ndodhur në Z.K. 3939 Zikularaj, Njësia Administrative Helmas.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet me qëllim zhvillimin e veprimtarisë bujqësore dhe/ose përdorim blegtoral.

4. Afati për dhënien me qira të 458/3 vol. 2 faqe 64 e llojit “pemëtores” me sip. 21870 m², Z.K. 3939 Zikularaj do të jetë në përputhje me parashikimet e kreut IV të Udhëimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” i ndryshuar, në varësi të kulturave bujqësore për të cilat do të merret me qira kjo pasuri.

5. Vlera dysHEME për detyrimin e qirase: 10000 (dhjetëmijë) lekë/ha për një vit kalendarik.

6. Konkurrimi publik për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbledhjeve, me datë 25.07.2025 në orën 11:00.

7. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit	40 pikë
Niveli i punësimit	30 pikë
Çmimi i ofruar (lekë/ha në vit)	30 pikë

8. Subjektet konkurrese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim e cila të përmbajë të dhënat e kërkuarit, pasurinë e cila kërkohet të merret me qira e identifikuar me numrat kadastralë përkatës
- Oferta për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha/në vit)
- Qëllimin e marrjes në përdorim të pasurisë shtetërore
- Planin e biznesit të hollësishëm në të cilin të përcaktohet qartë:
 - a. veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari,
 - b. aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohen në kultivimin e bimëve si dhe përpunimin e produkteve
 - c. investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.) të shprehura në tregues fizikë dhe monetar si dhe investimet e lidhura me mbjelljen dhe kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.
 - d. burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehur në vlerë monetare
 - e. analizë e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij
 - f. niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara

- Deklaratë në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
 - Deklaratë për të dhënat e Nuis/Nipt të subjektit kërkuar
 - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore
 - Deklaratë për administratrorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin
- Në rast se subjekti konkurues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë, në objekte pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, komisioni e s'kualifikon subjektin konkurrues.

Mosparaqitja e njërës prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

11. Data e zhvillimit të konkurrimit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, në sallën e mbledhjeve, me datë 25.07.2025 në orën 11:00.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 25.07.2025 në orën 11:00.